



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 13 Dt. 05.01.2024
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Në mbështetje të nenit 46 paragrafi 1 pika g), nenit 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. pika a) të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Komisioni Disiplinor i FBK-së, pas zhvillimit të procedurës disiplinore mori këtë

V E N D I M

- I. Blerim Krsniqi, trajner i SHB Dardania, për shkelje të rëndë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: **Ndalesë në kryerje të detyrës për periudhë të caktuar kohore, prej tre (3) muaj.**
- II. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Komisioni Disiplinor (këtu e tutje Komisione) nëpërmjet postës elektronike, më datën 05.12.2023, ka pranuar email nga sekretarja e përgjithshme, znj. Elvira Duhku, në të cilin ka gjetur të bashkëngjitur kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj Blerim Krsniqi, trajner i SHB Dardania, nën dyshimet e bazuara se ka aktivizuar në lojë lojtarin Eris Grushti, i cili ka tejkaluar moshën e lejuar për tu paraqitur në kuadër të ndeshjes së zhvilluar ndërmjet Kerasan B - SHB Dardania ("INFORMATORI NR 4 SUPERLIGA U16 LINDJE XHIROJA IV").

Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, Komisioni, më qëllim që menjëherë të filloj me shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore, me datën 07.12.2023, në orën 17.00, në lokalet e FBK-së, ka mbajtur takimin e parë shqyrtues, me ç' rast ka dizajnuar administrimin e procesit për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit. Në kuadër të këtij takimi, Komisioni, në përbërje të plotë dhe aprovim të të gjithë anëtarëve vendosi që për qëllime të verifikimit të fakteve dhe në zbatim të drejtë të Rregullores Disiplinore të FBK-së, duke zbatuar nenin 38 të Rregullores Disiplinore, nëpërmjet shërbimeve të sekretarisë të FBK-së, për t'u njohur me variantin e ngjarjes apo të problemit, Blerim Krsniqit, trajner i SHB Dardania, t'i kërkojë që të deklarohet më shkrim.

Për qëllime të trajtimit të lëndës, përveç takimit të datës 07.12.2023, Komisioni është takuar edhe më datën 19.12.2023. Në takime kanë qenë prezent: Fidan Hamiti - kryetar, Afrim Kamishi – anëtar, Omer Daku – anëtar, si dhe në përputhshmëri me

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



REPUBLIKA E KOSOVËS

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsors:

Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

nenin 36 të Rregullores Disiplinore, prezent kanë qenë edhe Elvira Dushku, sekretare e përgjithshme e FBK-së dhe Enea Hajdari, këshilltarë ligjore për sport e FBK-së.

Më datën 19.12.2023, Komisioni, nëpërmjet email-it, nga shërbimet e sekretarisë të FBK-së, sipas kërkesës ka pranuar Deklaratën e z. Blerim Krasniqi, trajner i SHB Dardania.

Në Deklaratën e tij z. Krasniqi ndër të tjera ka thënë (teksti pa ndërhyrje):

“Fillimishte iu njoftoi se kjo që ka ndodhe ? ka ndodhe pikerisht kur une kam patur probleme shendetesore dhe ate shum seioze? Te papritura pastaj pas operacionit që fal zotit kaloi mire? Une iu ketheva ekipit dhe kjo ndodhi ne lojepasi që gabimishte e kam fut ne loje me Kerasanin Eris Grushtin eshte pikerishte se ky lojtare i mbush 16 vite me 30 -12 2023 dhe perveq kesaj Eris ka qen i regjistruar ne rester dhe ashte per qudi që sashte larguar nga komesari i garave nga U16 ??”

Ajo që Komisioni ka kuptuar nga Deklarata e z. Krasniqi, lidhet me konstatimet e Komesarit të Garave, z. Xhelal Mumini, i cili këtë e ka artikuluar në Informatorin Nr. IV – Superliga U16, Lindje, Xhiroja e IV, i nxjerrë në bazë të raportit të vëzhguesit të ndeshjes, ndeshje e zhvilluar më datën 28/29.10.2023, ku ndër të tjera thuhet (teksti pa ndërhyrje) “Ekipia e cila aktivizon lojtarë (Eris Grushti) që nuk përputhen me moshën e lejuar për garat në atë kategori, pasi është verifikuar se janë të regjistruar me shënime të rrejshme ose dokumente të falsifikuara i shlyhen të gjitha rezultatet, përjashtohet nga gara për vitin garues në vijim dhe edicionin e ardhshëm në atë kategori, ndërsa ndaj personave përgjegjës (Blerim Krasniqi) organi i autorizuar disiplinor i FBK-së do të marrë masa ndëshkuese në bazë të Rregullores disiplinore të FBK-së.”

Komisioni disiplinor, ka shqyrtuar me kujdes pretendimet në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, sipas “INFORMATORI NR 4 SUPERLIGA U16 LINDJE XHIROJA IV” dhe i ka krahasuar ato me deklaratat dhe provat e prezantuara nga z. Blerim Krasniqi, trajner i SHB Dardania dhe me dëshmitë tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës, si dhe me dokumentet ligjore në funksion të zhvillimit të procedurës disiplinore dhe ka ardhur në përfundim se, me paraqitjen e lojtarit Eris Grushti, në ndeshjen KB Kerasan B – SHB Dardania, jashtë moshës së lejuar për kategorinë përkatëse, z. Blerim Krasniqi ka kryer veprim i cili konsiderohet si shkelje e rëndë disiplinore, i cili si i tillë sanksionohet me nenet si në preambulën e këtij vendimi.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina


Komisioni ka marrë për bazë të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikuar të i njëjti për të bërë një veprim të tillë, mirëpo nuk ka mundur ta justifikoj faktin e shkëljes së kryer dhe sidomos ndikimi që lojtari i aktivizuar ka mund ta ketë në epilogun final të ndeshjes.


Megjithatë, në shqiptim dhe matje të dënimit Komisioni ka marrë për bazë rrethanat ndikuese që lidhen me shëndetin e trajnerit të cilat mund të kenë ndikuar që i njëjti ta ketë bërë një veprim të tillë, si dhe ato lehtësuese të cilat sa i përket trajnerit Krasniqi lidhën me kontributin e tij shumëvjeçar në basketboll.

Andaj duke u mbështetur në atë që u tha më lart, Komisioni Disiplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR :


Omer Daku, anëtar


Fidan Hamiti, kryetar


Afrim Kamishi, anëtar

Prishtinë, 05.01.2024

Vendimi t'u dërgohet:

- Blerim Krasniqi,
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FBK-së dhe
- Arkivit të FBK-së.



KËSHILLË JURIDIKE:

Konform Nenit 42 të Rregullores Disiplinore, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrahet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Arbitrazhit të FBK-së. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën në shumën prej 300 €, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:

